

## **DRAFT-RELACION**

### **PËR**

### **PROJEKT LIGJIN**

### **“PËR EFIÇENCËN ENERGJETIKE ”**

#### **I. QËLLIMI I PROJEKT LIGJ DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

- Kyprojekt-ligj ka për qëllim të përcaktoj një kuadër masash për të promovuar eficiency energjetike me qëllim që të sigurohet arritja e objektivave kombëtare dhe mundësohen përmirësime të mëtejshme të eficiency energjetike në të gjithë sektorët duke sjellë përdorim racional të burimeve energjetike si dhe rritjen e konkurreshmërisë së operatorëve.

- Ky projekt-ligj ka si objektiv:

a)vendosjen e eficiency energjetike në krye për të gjithë sektorët;

b)heqjen e pengesave në tregun e energjisë për furnizimin, transmetimin, ruajtjen si dhe përdorimin e energjisë.;

c)përcaktimin e objektivave kombëtare për kursimin e energjisë dhe rritjen e sigurisë së furnizimit me energji;

d)rritjen e konkurreshmërisë së operatorëve

#### **II. VLERËSIMI I PROJEKT LIGJ NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Ky projekt ligj është në përputhje me arritjen e objektivave kombëtare për eficiency e energjisë,si dhe është përgatitur në mbështetje të Programit Kombëtar për Aderimin në Bashkimin European 2024-2030 dhe Planit Analitik te Akteve për vitin 2025.

#### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKT LIGJIT ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT DHE EFEKTET E PRITSHME**

Ky projekt ligj ka si qëllim të përmirësojë efikasitetin e energjisë dhe është një hap i rëndësishëm drejt arritjes së objektivave klimatike dhe zhvillimit të qëndrueshëm

Më poshtë janë të parashtruara përparësitë, problematikat dhe efektet e pritshme të këtij projektligji.

## 1. Përparësitë:

- **Përmirësimi i efikasitetit energjetik:** Ky projektligj synon uljen e konsumit të energjisë përmes masave që nxisin investimet në teknologji më efikase dhe inovative, duke ulur kështu varësinë nga burimet e jashtme të energjisë dhe duke kontribuar në qëndrueshmërinë e ekonomisë.
- **Krijimi i mundësive për inovacion:** Ky projektligj do të nxisë zhvillimin dhe adoptimin e teknologjive të reja që mund të rrisin efikasitetin energjetik, si në sektorët e industrisë ashtu edhe në ato të ndërtimit dhe transportit.
- **Përbushja e objektivave të klimës dhe angazhimet ndërkombëtare:** Ky projektligj kontribuan në objektivat e BE-së për reduktimin e gazeve serrë dhe kalimin në një ekonomi të gjelbër.
- **Mbështetje për energjinë e rinovueshme:** Përmirësimi i efikasitetit të energjisë do të mbështesë integrimin më të lehtë të burimeve të rinovueshme, si hidroenergjia, era dhe dielli në rrjetin energjetik dhe do të ndihmojë në përdorimin më të gjerë të energjisë së gjelbër.
- **Përmirësimi i cilësisë së jetesës dhe shëndetit publik:** Ulja e ndotjes dhe përmirësimi i efikasitetit të energjisë do të sjellin përfitime të drejtpërdrejta për cilësinë e ajrit dhe shëndetin e qytetarëve, veçanërisht në zona urbane ku ndotja e ajrit është një shqetësim i madh

## 2. Problematikat:

- **Kostot e larta të implementimit dhe financimi:** Një nga sfidat kryesore që mund të hasë ky projektligj është shpenzimi i madh fillestar për të implementuar teknologjitë e efikasitetit energjetik. Shumë sektorë dhe individë mund të hasin vështirësi në mbulimin e kostove të kërkuara për të modernizuar infrastrukturën dhe për të zbatuar masat për efikasitetin energjetik.

- **Nevoja për koordinim me sektorët e tjerë:** Implementimi i efijencës energjetike kërkon një bashkëpunim të ngushtë ndërmjet administratës publike, sektorëve privatë dhe shoqërisë civile, e cila mund të jetë një sfidë për Shqipërinë nëse nuk ka një koordinim të fortë mes aktorëve të ndryshëm.
- **Mungesa e kapaciteteve dhe trajnimeve:** Përdorimi i teknologjive të reja mund të kërkojë trajnim dhe zhvillim aftësish të reja nga punonjësit dhe profesionistët e fushës. Shqipëria ka nevojë për më shumë investime në arsimin dhe trajnimin e burimeve njerëzore për të mbështetur këtë kalim në teknologjitë e gjelbra dhe efijente.

### 3. Efektet e pritshme:

- **Reduktimi i konsumit të energjisë dhe përmirësimi i bilancit të energjisë:** Mund të arrihet një ulje e konsiderueshme e kërkesës për energji përmes masave për efijencës energjetike. Kjo do të ulë nevojat për importimin e energjisë dhe do të përmirësojë bilancin energjetik të vendit.
- **Reduktimi i ndotjes dhe përmirësimi i shëndetit publik:** Efektet pozitive në cilësinë e ajrit dhe shëndetin e qytetarëve do të jenë të ndjeshme, sidomos në qytetet e mëdha, ku ndotja është një shqetësim i rëndësishëm.
- **Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar:** Duke përmbushur angazhimet e BE-së dhe përmirësuar efijencën energjetike, Shqipëria mund të forcojë marrëdhëniet me partnerët ndërkombëtarë dhe të tërheqë më shumë financime për zhvillimin e projekteve të energjisë së rinovueshme dhe efijencën energjetike.

## IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Hartimi i këtij kuadri ligjor është bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në kuadër të procesit të integrimit Evropian për sektorin e energjisë me synim integrimin gradual të Shqipërisë, ka ndërmarrë iniciativën për të propozuar ligjin e ri në fushën e efijencës energjetike .

Draft ligji “Për efijencën energjetike” shfuqizon Ligjin në fuqi Nr.124/2015 “Për Efijencën e energjisë” i ndryshuar dhe është pjesërisht në përputhje me direktivën europiane (EU) 2023/1791 “Për Efijencë energjetike”

## **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNITAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)**

Ky projekt-ligj është pjesërisht në përputhje me Acquis Communautaire. *“Ky ligj është përafuar pjesërisht me Direktivën (BE) 2023/1791 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 24 Prill 2024 “Për Eficiencën Energjetike”*.

## **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKT LIGJIT**

### **Kreu I: Parime të përgjithshme**

Qëllimi i këtij projektligji është të krijojë një kuadër masash për promovimin e eficiencës energjetike, me qëllim arritjen e objektivave kombëtare dhe përmirësimin e përdorimit të burimeve energjetike, duke rritur konkurrueshmërinë e operatorëve në të gjithë sektorët.

Ky ligj ka për objekt vendosjen e eficiencës energjetike si prioritet në të gjitha fushat e energjisë dhe heqjen e pengesave për furnizimin dhe përdorimin e energjisë, si dhe përcaktimin e objektivave kombëtare për kursimin e energjisë dhe rritjen e sigurisë së furnizimit.

Ligji zbatohet për:

Personat juridikë që merren me prodhimin, transmetimin, shpërndarjen dhe furnizimin me energji.

Konsumatorët fundorë të energjisë, si persona fizikë dhe juridikë.

Personat që ofrojnë shërbime energjetike për përmirësimin e eficiencës energjetike.

### **Kreu II: Objektivat dhe parimi i politikave të eficiencës energjetike**

Republika e Shqipërisë përcakton objektivat kombëtare për eficiencën energjetike në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë, duke kontribuar në arritjen e objektivave të përgjithshme në nivel rajonal. Këto objektiva shprehen në terma të konsumit final të energjisë, shoqërohen me një vlerë të konsumit primar dhe mbështeten nga një trajektore orientuese për arritjen e tyre.

Në përcaktimin e kontributit kombëtar merren në konsideratë një sërë faktorësh, përfshirë objektivat e vendosura nga Sekretariati i Komunitetit të

Energjisë, masat ekzistuese dhe të planifikuara për efikasitetin energjetik, si dhe karakteristikat e ekonomisë dhe potenciali për kursime energjie. Gjithashtu, vlerësohen rrethana të tjera si zhvillimet makroekonomike, ndryshimet në përzjerjen energjetike, dekarbonizimi i sektorëve me intensitet të lartë energjie dhe kushtet klimatike.

Si pjesë e këtij kontributi, raportohen të dhëna mbi konsumin e energjisë sipas sektorëve kryesorë (industri, rezidencial, shërbime dhe transport), si dhe projeksione për sektorin e teknologjive të informacionit dhe komunikimit. Objektivat dhe trajektorja përkatëse përfshihen në Planin Kombëtar për Energjinë dhe Klimën (NECP) dhe përditësohen periodikisht.

Progresi drejt arritjes së objektivave monitorohet dhe vlerësohet nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë. Në rast se kontributi kombëtar ose progresi drejt tij rezulton i pamjaftueshëm, kërkohet rishikimi i tij dhe marrja e masave shtesë, si forcimi i politikave, rritja e detyrimeve për kursime energjie dhe shtimi i mbështetjes financiare.

Në rast devijimi nga trajektorja e përcaktuar, autoritetet përgjegjëse duhet të shpjegojnë arsyet dhe të përcaktojnë masat konkrete për rikthimin në trajektore, duke siguruar arritjen e kontributit kombëtar për efikasitetin energjetik.

### **Kreu III: Modeli shembullor i sektorit publik**

Parimi “Efikasiteti energjetik në Krye” i jep përparësi efikasitetit energjetik në politikëbërje dhe në zbatimin e projekteve në sektorin energjetik dhe jo-energjetik, si transporti, ndërtesat, industria dhe bujqësia. Autoritetet publike janë të detyruara të integrojnë këtë parim në planifikim dhe investime të mëdha.

Institucionet publike duhet të aplikojnë efikasitetin energjetik në prokurimet publike, duke marrë parasysh kostot gjatë ciklit të jetës së produkteve dhe shërbimeve. Kjo metodologji është e detyrueshme për produkte që kanë ndikim në energji.

Kur prokurorohen produkte dhe shërbime, autoritetet kontraktore duhet të sigurojnë se ato janë të përputhshme me kërkesat për efikasitetin energjetik, siç përcaktohet nga standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, përfshirë automatet e energjisë së ulët dhe ndriçimin efikas.

Qeveria dhe njësitë e qeverisjes vendore duhet të monitorojnë dhe raportojnë kursimet e energjisë dhe të zhvillojnë plane lokale për efikasitetin energjetik, me qëllim arritjen e objektivave të kursimit çdo vit, duke përfshirë angazhimin për të paktën një menaxher energjie në secilën njësi të qeverisjes vendore.

#### **Kreu IV: Efikasiteti në përdorimin e energjisë**

Këshilli i Ministrave do të vendosë një objektiv kombëtar për kursimin e energjisë, bazuar në mundësitë reale ekonomike dhe konsumin e energjisë. Objektiv i kursimit duhet të arrihet përmes masave të ndryshme në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, si sektori rezidencial, shërbimeve, industrisë, transportit dhe bujqësisë. Ky objektiv do të përcaktohet në Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës. Përpjekjet për rritjen e efikasitetit energjetik do të marrin parasysh faktorë të tillë si intensitetin energjetik të ekonomisë, potencialin për kursime, zhvillimin e energjisë së rinovueshme, dekarbonizimin e industrive dhe ndryshimet klimatike.

Vendosja e një skeme detyruese për promovimin e përdorimit të energjisë në mënyrë efikase dhe reduktimin e humbjeve. Palët e detyruara për të arritur kursime energjie janë: kompanitë e shitjes së energjisë, operatorët e sistemeve të shpërndarjes dhe transmetimit, si dhe konsumatorët e mëdhenj të energjisë. Kursimi vjetor duhet të jetë të paktën 0.8% e shitjeve të energjisë. Palët e detyruara mund të zbatojnë masa të ndryshme për të arritur këto kursime, përfshirë riparimin e ndërtesave, zëvendësimin e pajisjeve dhe instalimin e matësve inteligjent. Agjencia përgjegjëse për efikasitetin energjetik do të administrat skemën dhe të raportojë për arritjen e objektivave.

Auditimet energjetike realizohen nga auditues të certifikuar ose nga persona juridikë që punësojnë auditues të tillë, dhe janë të detyrueshme për konsumatorët e mëdhenj të energjisë dhe ata që aplikojnë për fonde për efikasitetin energjetik. Gjatë auditimit, përgatitet një raport që përfshin vlerësimin e konsumit të energjisë, propozimin e masave për kursimin e energjisë, dhe një analizë për mundësitë e kursimeve të energjisë dhe prodhimin nga burime të rinovueshme.

Konsumatorët e mëdhenj të energjisë dhe njësitë e qeverisjes vendore duhet të punësojnë një menaxher energjie. Ky person është përgjegjës për mirëmbajtjen e pajisjeve që përdorin energji dhe për përmirësimin e përdorimit racional të energjisë në ndërtesa dhe industri.

Ekspertët që kryejnë auditime dhe menaxhim energjetik duhet të jenë të certifikuar dhe të punojnë në mënyrë të pavarur ose përmes persona juridikë. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit për energjinë, përcakton procedurat dhe kërkesat për certifikimin e ekspertëve, të cilët mund të jenë auditues energjetik për instalime industriale ose menaxherë energjie.

Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit për energjinë, miraton procedurat dhe kriteret për mbikëqyrjen e shërbimeve të kryera nga ekspertët e certifikuar. Procesi i mbikëqyrjes realizohet nga ekspertë të certifikuar nga ministria përgjegjëse për energjinë, të cilët kanë punuar më shumë se tre vjet në institucionet publike.

Qendrat e të dhënave me fuqi të instaluar më të madhe se 500 kW, duke filluar nga viti 2026, duhet të publikojnë informacionin përkatës. Ky detyrim nuk vlen për qendrat që lidhen me mbrojtjen kombëtare ose civile. Agjencia përgjegjëse për eficientë do të krijojë një regjistër të dhënash dhe do të hartojë praktika më të mira për eficientë energjetike të qendrave të të dhënave.

## **Kreu V: Sistemet e matjes dhe faturimit të konsumit energjetik**

Operatorët e furnizimit me gaz natyror janë të detyruar të sigurojnë matës individualë për çdo klient fundor, që reflektojnë konsumin aktual të energjisë dhe ofrojnë informacion në kohë reale, nëse është teknologjikisht dhe financiarisht i mundur. Matësat individualë duhet të instalohen kur bëhet lidhja e re me gaz ose kur një ndërtesë i nënshtrohet rinovimit të konsiderueshëm për performancën energjetike.

Subjektet që ofrojnë shërbime ngrohjeje, ftohjeje dhe ujit të ngrohtë sanitar duhet të instalojnë matës për të pasqyruar saktësisht konsumet e energjisë për klientët fundorë. Kur këto shërbime ofrohen nga burime qendrore, matësat duhet të vendosen në shkëmbyesin e nxehtësisë ose në pikën e dorëzimit.

Enti Rregullator i Energjisë miraton kërkesat për faturimin dhe siguron që informacioni mbi konsumimin dhe faturat e energjisë të jetë në dispozicion të konsumatorëve, duke u mundësuar atyre të krahasojnë opsionet dhe të kenë akses në informacionin e nevojshëm pa pagesë.

## **Kreu VI: Informimi dhe fuqizimi i konsumatorëve fundorë**

Klientët fundorë kanë të drejtën për një kontratë që përfshin detaje të shërbimeve, çmimet, kushtet e ndryshimit dhe të drejtat për ankesë, ndërsa

furnizuesit janë të detyruar të ofrojnë kushte të drejta dhe transparente. Ata gjithashtu mund të kenë mundësi pagese të ndryshme dhe do të njoftohen për çdo ndryshim në kontratë.

Agjencitë dhe autoritetet përkatëse ofrojnë informacion për masat e efijencës energjetike dhe mbështetje financiare, teknike dhe administrative për konsumatorët. Po ashtu, promovohet përdorimi i energjisë efijente përmes strategjive, stimujve fiskalë dhe bashkëpunimit me aktorë privatë, ndërsa zgjidhja e mosmarrëveshjeve bëhet pa gjykatë përmes strukturës ZAM.

### **Kreu VII: Efijenca në shpërndarjen e energjisë**

Ministria e Energjisë, përmes agjencisë për efijencën e energjisë, kryen një analizë të mundësive për efijencën në ngrohje dhe ftohje, përfshirë vlerësimin e kostos dhe përfitimit. Ky proces përfshin gjithashtu përgatitjen e planeve lokale dhe masave për rritjen e efijencës energjetike. Njësitë lokale mund të krijojnë plane të ngrohjes dhe ftohjes bazuar në analizat e bëra nga autoritetet përkatëse.

Enti Rregullator i Energjisë (ERE) ka detyrën të sigurojë që operatorët e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes të përdorin analizat e kostos dhe përfitimit për të optimizuar efijencën energjetike. ERE gjithashtu do të monitorojë dhe mbështesë zhvillimin e rrjeteve inteligjente dhe do të inkurajojë investimet që kontribuojnë në zbutjen e ndryshimeve klimatike.

### **Kreu VIII: Fondi kombëtar për efijencën energjetike**

Kijimi i Fondit Kombëtar për Efijencën Energjetike si një entitet të pavarur dhe autonom, të qëndrueshëm për të mbështetur Qeverinë e Shqipërisë në arritjen e objektivave për efijencën energjetike. Fondi do të mbledhë dhe menaxhojë burime financiare për realizimin e projekteve të energjisë, dhe ka autonomi operacionale dhe administrative jashtë strukturave qeveritare. Burimet financiare të Fondit përfshijnë donacione, kthime nga investime, tarifa dhe pagesa të tjera që do të administrohen sipas ligjit përkatës dhe akteve nënligjore.

Sruktura e Fondit, përfshirën organet drejtuese, Këshillin Drejtues dhe Drejtorin Ekzekutiv. Këshilli Drejtues është përgjegjës për mbikëqyrjen e përgjithshme dhe merr vendime të rëndësishme, si emërimin e Drejtorit Ekzekutiv, miratimin e planeve dhe rregulloreve, dhe zhvillimin e strategjive

për financimin e projekteve. Anëtarët e Këshillit Drejtues duhet të kenë integritet të lartë dhe përvojë profesionale relevante.

Kompetencat e Këshillit Drejtues të Fondit përfshijnë emërimin dhe shkarkimin e Drejtorit Ekzekutiv, miratimin e planeve financiare dhe zhvillimore, zhvillimin e strategjive për mbledhjen e fondeve, dhe mbështetje për projektet e efikasitetit energjetike. Këshilli Drejtues është gjithashtu përgjegjës për mbështetje financiare për grupet më të cenueshme dhe për zhvillimin e programeve për kursime energjie dhe reduktim të emetimeve të karbonit.

### **Kreu IX: Agjencia për efikasitetin e energjisë dhe shërbimet energjetike**

Agjencia për Efikasitetin e Energjisë krijohet nga Këshilli i Ministrave dhe është një institucion në varësi të ministrit për energjinë. Ajo financohet nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera, duke përfshirë financime të huaja. Agjencia është përgjegjëse për zhvillimin, monitorimin dhe zbatimin e politikave dhe planeve për efikasitetin e energjisë në sektorët e ndryshëm, si rezidencial, industri, transport dhe bujqësi. Ajo gjithashtu bashkëpunon me autoritetet dhe organizatat për krijimin dhe përditësimin e bazave të të dhënave për energjinë dhe për të mbështetur masat për nxitjen e efikasitetit.

Agjencia promovon dhe ofron informacion për shërbimet energjetike, duke përfshirë kontratat për kursimin e energjisë dhe stimujt financiarë për projektet e kursimit. Informacioni për ofruesit e shërbimeve energjetike, si ESCO, dhe metodologjitë për monitorimin e kursimeve publikohet në faqen zyrtare të agjencisë. Shërbimet energjetike ofrohen përmes kontratave të performancës energjetike, të cilat përfshijnë masat për kursimin e energjisë dhe detajet për realizimin e kursimeve të garantuara. Ofruesi i shërbimit garanton kursime energjie dhe merr përsipër riskun, ndërsa përfituesi i shërbimit shmang kostot e investimeve duke përdorur një pjesë të kursimeve për t'i shlyer ato.

### **Kreu X: Dispozita horizontale**

Marrëveshjet vullnetare lidhin konsumatorët e mëdhenj të energjisë, bizneset e vogla dhe të mesme, dhe pronarët e ndërtesave me kompanitë e shërbimeve energjetike për të mbështetur masat e efikasitetit të energjisë. Këto marrëveshje duhet të jenë të qarta dhe transparente, përfshirë objektivat, detyrimet e palëve dhe metodologjinë e vlerësimit të kursimeve. Agjencia përgjegjëse mund të bëjë vlerësime të kostos dhe përfitimit të marrëveshjeve dhe promovon

ndërgjegjësimin për përfitimet e tyre. Marrëveshjet nxisin përfshirjen e subjekteve të tjera në përpjekjet për kursimin e energjisë.

Organet që lëshojnë certifikata për profesione të lidhura me efikasitetin e energjisë akreditohe në përputhje me Ligjin për Akreditimin. Ata që marrin certifikata duhet të ndjekin trajnime të formimit të vazhduar për të zgjeruar njohuritë e tyre profesionale, të cilat janë të akredituara dhe përputhen me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare. Agjencia publikon listën e organeve të akredituara dhe vlerëson skemat e trajnimit çdo tre vjet për të siguruar akses të barabartë dhe përmbushje të kërkesave profesionale. Vlerësimi mund të sugjerojë shtimin e profesionistëve në fushën e efikasitetit energjetik.

Në nenin 53 parashikohet rregullimi i orës zyrtare dhe kalimit në orën verore, si dhe vendosja e një periudhe tranzitore për kalimin e Republikës së Shqipërisë në zonën kohore GMT+2. Kjo dispozitë është në përputhje me Directive 2000/84/EC, e cila harmonizon datat e fillimit dhe përfundimit të orës verore në Evropë, pa vendosur detyrime për përcaktimin e zonës kohore, që mbetet kompetencë e shteteve. Në këtë kuadër, masa e propozuar përfaqëson një zgjedhje të arsyetuar të politikës publike, në funksion të përmirësimit të efikasitetit energjetik dhe optimizimit të përdorimit të burimeve natyrore.

Në kushtet aktuale, një pjesë e konsiderueshme e dritës natyrore në orët e mëngjesit mbetet e pashfrytëzuar, ndërkohë që kërkesa për energji elektrike rritet ndjeshëm në orët e pasdites dhe të mbrëmjes, kur aktiviteti ekonomik dhe shoqëror është në kulmin e tij. Kalimi në GMT+2 mundëson zhvendosjen e dritës natyrore drejt këtyre orëve, duke reduktuar nevojën për ndriçim artificial dhe duke kontribuar në uljen e konsumit të energjisë elektrike, veçanërisht në orët e pikut. Kjo sjell një përdorim më racional të energjisë dhe ul presionin mbi sistemin elektroenergjetik, duke reduktuar nevojën për importe dhe kostot e balancimit.

Njëkohësisht, kjo masë krijon sinergji të drejtpërdrejtë me zhvillimin e burimeve të rinovueshme, në veçanti energjinë diellore. Profili i prodhimit nga centralet fotovoltaike, i përqendruar në orët e mesditës, përputhet më mirë me kërkesën reale të energjisë nëse aktiviteti ekonomik zhvendoset në përputhje me GMT+2. Si rezultat, rritet niveli i vetëkonsumit të energjisë së prodhuar

nga burimet diellore, ulet sasia e energjisë së derdhur në rrjet dhe përmirësohet eficientia ekonomike e investimeve në këtë sektor.

Përfitimet e kësaj mase reflektohen drejtpërdrejt edhe tek konsumatorët, përmes uljes së nevojës për ndriçim artificial dhe, rrjedhimisht, reduktimit të kostove të energjisë për familjet dhe bizneset. Në të njëjtën kohë, rritja e përdorimit të dritës natyrore në orët aktive të ditës ndikon pozitivisht në produktivitetin, mirëqenien dhe cilësinë e jetës së qytetarëve, duke përmirësuar përshtatjen e ritmit të jetës me ciklin natyror të dritës.

Ky ndryshim është gjithashtu në përputhje me transformimet strukturore të ekonomisë dhe mënyrës së jetesës në Shqipëri, ku aktiviteti ekonomik dhe institucional zhvillohet kryesisht gjatë orëve të ditës dhe pasdites, duke e bërë të nevojshme një përshtatje më të mirë të orarit me realitetin urban dhe social. Për më tepër, përafrimi me zonën kohore të vendeve fqinje si Greqia, Bullgaria dhe Rumania lehtëson koordinimin ndërkuftar, veçanërisht në sektorin e energjisë, dhe mbështet integrimin e Shqipërisë në tregun rajonal dhe evropian të energjisë.

Nga pikëpamja e sistemit energjetik, kjo masë kontribuon në një shpërndarje më të balancuar të kërkesës gjatë ditës, duke përmirësuar operimin e rrjetit dhe duke ulur kostot e menaxhimit të tij. Në të njëjtën kohë, ajo mbështet objektivat afatgjata të tranzicionit energjetik, duke favorizuar integrimin më të mirë të burimeve të rinovueshme dhe duke rritur fleksibilitetin e sistemit.

Në përfundim, kalimi në GMT+2 përbën një masë me ndikim të gjerë pozitiv, e cila, pa kërkuar investime infrastrukurore shtesë, kontribuon në rritjen e eficientisë energjetike, uljen e kostove për konsumatorët, përmirësimin e funksionimit të sistemit energjetik dhe rritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve, duke u përshtatur me zhvillimet moderne ekonomike dhe objektivat e qëndrueshmërisë.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKT LIGJIT**

Për zbatimin e këtij projekt ligji ngarkohet Këshilli i Ministrave, Ministria përgjegjëse për energjinë, Ministria përgjegjëse për zhvillimin urban, Insitucionet e qeverisjes vendore, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Agjencia

përgjegjëse për Efiçencën e Energjisë, Agjencia përgjegjëse për Burimet e Rinovueshme të Energjisë.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKT LIGJIT**

Projek-ligji është përgatitur nga Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

**MINISTRI**

**Enea Karakaçi**